

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

01.11.2024

Ora 12:40

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” (vijon).*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar (online)
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Znj.M. Çelmeta, znj.P.Doçaj, znj.E. Demollari
- Parti Politike PS (znj.E.Xhina), PD (Z.F.Nuri), PL (z.K.Kolndreu)

**OJQ:**

**KRIIK**

*Znj. I. Nano:* Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 1 nëntor, në orën 12.30. Fillojmë me pak minuta vonesë, për shkak se jemi në një mbledhje hibride, duke pasur parasysh që katër nga anëtarët e Komisionit Rregullator janë të pranishëm në sallë, një prej tyre, z.Dritan Çaka është online. Z. Çaka, teknikisht jemi në rregull, na dëgjoni?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Z. D. Çaka:** Po, përshëndetje! Unë ju dëgjoj mirë, nuk e di ju si më dëgjoni, si më shikoni?

**Znj. I. Nano:** Po, faleminderit! Të dëgjojmë mirë. Në këtë mbledhje të pranishëm janë, Sekretarja e Përgjithshme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës, përfaqësues të partive politike, të Partisë Demokratike, të Partisë së Lirisë, të Partisë Socialiste, përfaqësues të shoqërisë civile. Ndërkohë, janë lidhur, bashkë me kolegun Çaka dhe po na ndjekin online, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile brenda vendit, organizata që përfaqësojnë diasporën jashtë vendit, organizata ndërkombëtare. Pra, gjithë ai rreth organizatash, të cilëve ne u dërgojmë njoftimet për mbledhje, sot janë të lidhur me ne. Në mbledhjen e kaluar, nisëm të shqyrtonim projektvendimin “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Kemi votuar në parim dhe nuk vijum më me diskutimin nen për nen. Me kërkesë të dy anëtarëve të Komisionit Rregullator, znj.Vukaj dhe z.Çakaj, organizuam një takim konsultativ me organizatat sikundër thamë, të shoqërisë civile brenda vendit dhe ato të diasporës, jashtë vendit. Pikë tjetër në rendin e ditës ne nuk kemi. Kështu që unë do të pyes kolegët nëse kanë çështje të tjera jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë? Nuk kemi. Atëherë fillojmë me rendin e ditës dhe pasi kemi mbaruar me miratimin në parim të projektvendimit, kalojmë nen për nen, kre për kre, pikë për pikë. Atëherë, projektvendim “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh” dhe nenit 25, pika 5, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

Kreu I “Rregulla të përgjithshme”

1. “Zgjedhësi për regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.
2. “Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në një nga dokumentet që paraqet në KQZ, sipas pikës 5, të nenit 25, të ligjit “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të dhënat e identitetit të shtetasit që kërkohen të verifikohen nga KQZ-ja, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe nëse ato janë të njëjta bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në një rubrikë të veçantë”.

Atëherë për kreun e parë keni ndonjë diskutim? Zoti Çakaj, po!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit e nderuar! Atëherë, së pari vlerësoj procesin konsultativ që kemi zhvilluar me shoqatat e diasporës dhe organizatat, të cilat kanë kontribuar dhe kanë dhënë një ndihmë të veçantë në hartimin e gjithë kuadrit legjislativ, nënligjor lidhur me administrimin e zgjedhjeve. Së dyti, pasi lexuat titullin e projektvendimit dhe kreun e parë, unë propozoj që titulli i projektvendimit, referuar nenit 25, pika 5, të Kodit Zgjedhor, si dhe referuar përcaktimit në kreun III. 2, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 10 të Komisionit Rregullator, që kemi miratuar përpara disa ditësh, propozoj të ndryshohet si vijon, projektvendim “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar, që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”. Pra, titulli të përqsë së pari parashikimet e nenit 25, pika 5 të Kodit Zgjedhor, e materializuar dhe me ndryshimet, me saktësimet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

përkatëse në vendimin nr. 10, të miratuar nga ne. Pra kemi, së pari qëndrimin, provën për qëndrimin, lista e dokumentacionit do të duhet për të vërtetuar qëndrimin e shtetasit shqiptar që ka shprehur vullnetin për të votuar nga jashtë. Së dyti, sigurisht për të mundësuar regjistrimin e tij në listën e zgjedhësve nga jashtë do të duhet që titulli të parashikojë dhe këtë qëllim. Pra, paraqitja e dokumentacionit me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve. Gjithashtu, duke qenë se nga procesi konsultativ, si dhe në takimet që kemi zhvilluar ne, së bashku me anëtarët e Komisionit Rregullator, kemi rënë dakord që të gjithë që lista e dokumentacionit nuk është shteruese. Në rastin konkret unë propozoj që të hiqet fjala “e detajuar e dokumentacionit”, pasi siç do të vijojë dhe më pas shqyrtimi biem dakord që ne do të përfshijmë, besoj me dakordësinë e të gjithëve, çdo dokument i cili provon qëndrimin jashtë territorit. Kështu që propozimi im konkret për titullin e projektaktit është, bëhet vendim “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”. Mund ta hedhim në votim këtë sepse kam dhe propozime për rregullat e përgjithshme, si ta gjykoni?

**Znj. I. Nano:** Meqenëse unë lexova dhe “Rregulla të përgjithshme”, keni diçka për “Rregulla të përgjithshme”?

**Z. M. Çakaj:** Po, kemi dhe diçka. Atëherë, të shtohet fjala “Kreu 1” te “Rregulla të përgjithshme”

**Znj. I. Nano:** Këto t’i bëjmë kreu 1, kreu 2, të gjitha?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Po, me radhë. Në pikën 2, të kreut 1, të fjalës së parë “Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mbështetet në një nga dokumentet që paraqet në KQZ, sipas pikës 5, neni 25, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar”, të shtohen fjalët “si dhe sipas kreut 2, pika 1, të këtij vendimi”. Po kështu kam dhe propozimin që fjalës së dytë, “Të dhënat e identitetit të shtetasit kërkohen të verifikohen nga KQZ, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe nëse ato janë të njëjta të bëhet nga DPGJC-ja regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Unë propozoj që kjo fjali të hiqet pasi është përsëritje nga vendimi nr.10, i miratuar tashmë nga Komisioni Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Kështu që është thjesht përsëritje.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Çakaj! Kolegë, deri tani për kreun 1, përfshirë dhe titullin që propozoi z. Çakaj, keni ndonjë propozim tjetër përpara se të kalojmë në votim? Nuk kemi. Atëherë, më së pari duhet të votojmë titullin e projektvendimit, sipas propozimit të z.Çakaj, pra, “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që jeton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”.

**Kolegë kush është dakord?**

**Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s’ka!**

**Miratohet me 5 vota pro!**

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

Atëherë tek Kreu 1 “Rregulla të përgjithshme”, kolegu Çakaj ka dy propozime, të cilat do t’i votojmë veç e veç. Pra, në fjalinë e parë, në fund të fjalisë të shtohet: “si dhe sipas kreut 2, pika 1 të këtij vendimi”.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s’ka!***

***Miratohet!***

Propozimi i dytë, të hiqet fjalia e dytë, e cila në fakt është përmendur në vendimin nr.10, të Komisionit Rregullator dhe buron drejtpërdrejt nga ligji.

***Kush është dakord, kolegë?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s’ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Kalojmë tek kreu 2 dhe sikundër thamë, do t’i lutesha administratës që kërret të shënohen, “Kreu 1”, “Kreu 2”, jo thjesht me pika. Atëherë në projektaktin e propozuar:

Kreu 2 “Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Pika 1. “Gjatë paraqitjes së kërkesës së tij për regjistrim”, po ta lexoj kreun, pastaj çfarëdo propozimi e bëjmë. Pika 1. “Gjatë paraqitjes së kërkesës së tij për regjistrim në

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

listën e zgjedhësve jashtë vendit sipas rregullave të miratuara nga Komisioni Rregullator, zgjedhësi ngarkon në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER), të paktën një nga dokumentet e listuar më poshtë që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.” Po filloj dhe do t’i vendos a, b, c. Kolegë jeni dakord? Pra kjo të jetë thjesht gjatë zbardhjes.

“a) Certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent në shtetin e rezidencës që provon pronësinë e banesës.

b) Vërtetim banimi ose dokument tjetër ekuivalent i lëshuar nga organet shtetërore të vendit të rezidencës ku përcaktohet adresa e banimit.

c) Kontratë qiraje ose huapërdorje e banesës.

d) Kontratë kredie për blerje të banesës.

e) Kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë.

f) Kontratë furnizimi ose faturë të energjisë (gaz ose elektrike) në banesë.

g) Kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjital të transmetimeve audio-vizive.

h) Kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit, telefonisë fikse në banesë.

i) Dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni apo tjetër të ngjashëm.”

Atëherë nisim diskutimin për këtë kre. Kush ka diskutime, propozime? Zoti Çakaj, po. Pastaj zonja Vukaj.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, duke qenë se ne ramë dakord që ta ndryshojmë titullin e projektvendimit, unë mendoj që kreu 2 është posaçërisht kur bëhet fjalë, duhet të transpozohet i njëjti formulim, ku bëhet fjalë në mënyrë të detajuar ku listohen dokumentat që kërkohen për vërtetimin e qëndrimit të zgjedhësit jashtë territorit.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Pra titullin e projektligjit ta kemi si titull i këtij kreu?

**Z. M. Çakaj:** Titulli të ndryshohet, njësoj si titulli i projektvendimit, pra “Lista e dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”.

**Znj. I. Nano:** Atëherë për titullin kemi diçka tjetër që më tej të kalojmë te përmbajtja e kreut? Të votojmë titullin njëherë? Kush është dakord me ndryshimin e propozuar nga z. Çakaj, për ndryshimin e titullit të kreut?

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s’ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Ndryshon titulli i kreut 2 dhe është njëlloj si titulli i projektvendimit që e miratuam. Në përmbajtje të kreut 2, te lista e dokumentave, zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Meqenëse kolegu Çakaj e përshtati më së miri kreun, më lejoni që edhe pas falenderimit që do të bëj posaçërisht për mbledhjen shumë rezultative dhe frytdhënëse, për pjesën e gjykimit tim. Më dha një tjetër optikë për ta riparë aktin, me organizatat e diasporës, të cilat vërtet dhanë një kontribut të vyer, duke na shpalosur variacione dokumentash ku doli në të vërtetë që kjo listë e paraqitur nuk është shteruese. Kjo listë nuk është shteruese për shkak se vende të ndryshme kanë eksperiencë të ndryshme, por nga ana tjetër edhe nuk mund të shterojë sepse mund të ketë edhe dokumenta të cilat ne ende nuk kemi dijeni apo vetë organizatat

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

nuk kishin dijeni sepse kanë eksperiencë të posaçme në disa vende të caktuara. Me këtë rast, pas përpunimit të të gjithë sugjerimeve të organizatave të diasporës dhe rishikimit më me kujdes të gjithë listës të dokumentacionit, të servirur në aktin e ardhur përpara kësaj mbledhje. Do ju ftoja kolegë të dëgjoni këtë propozim dhe njëherësh ta miratoni këtë propozim, pasi mendoj që përmbush më së miri atë merakun e gamës së kufizuar, apo moskufizimit të gamës. Unë do të nisja me pikën “i”, ku në aktin e vjetër thuhet specifikisht “Certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent në shtetin e rezidencës që provon pronësinë e banesës”, ndërkohë që unë do ta zëvendësoja me një propozim i cili më duket më adekuat, ku mendoj se i përshtatet më së miri gamës së dokumentacionit që mund të provojnë pronësinë. Do ju thosha...

**Znj. I. Nano:** Znj. Vukaj, në vëmendje të administratës. Zonja Vukaj, kolegu Çakaj, paraprakisht kanë thënë që do të bëjnë disa propozime për shtesa dhe ndryshime, do doja vëmendjen, unë po mbaj shënimet e mia që më mirë t’i kemi një nga një votimet. Pra, zonja Vukaj që menduat të zëvendësoni pikën e parë.

**Znj. H. Vukaj:** Për ekonomizim kohe unë po vijoj me gjithë propozimet të cilat automatikisht zëvendësojnë pikat në aktin e vjetër, kështu që e ka më të lehtë administrata.

**Znj. I. Nano:** Për procedurë, kemi një propozim zyrtar dhe një ndryshim.

**Znj. H. Vukaj:** Për procedurë unë do t’i lexoj. Atëherë unë propozoj që pika “i” duhe të jetë: “Dokument pronësie ose ekuivalent i lëshuar në shtetin e rezidencës që provon pronësinë e banesës.”

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Kalojmë me votimin e kësaj pike, pra zëvendësimin i “Certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent” me këtë që sapo propozoi znj. Vukaj “Dokument pronësie ose ekuivalent”.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s’ka!**

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Një propozim i miratuar, një dokument i sapo miratuar.

**Znj. H. Vukaj:** Në aktin ekzistues, pra atë të votuar në parim, kemi pikën 2, e cila thotë “Vërtetim banimi ose dokument tjetër ekuivalent, i lëshuar nga organet shtetërore të vendit të rezidencës, ku përcaktohet adresa e banimit”. Ndërkohë propozimi im është: “Dokument që provon rezidencën në shtetin e huaj i lëshuar nga autoritetet përkatëse”.

**Znj. I. Nano:** Për këtë pikë ka ndonjë propozim tjetër nga kolegët? Z. Çaka është në linjë? M’u duk sikur u shkëput.

**Z. D. Çaka:** Në linjë jam.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Nëse s’ka propozim tjetër, për këtë pikë, pra që zëvendëson pikën b, kalojmë në votimin e propozimit të znj. Vukaj. “Dokument që provon rezidencën në shtetin e huaj i lëshuar nga autoritetet përkatëse”.

**Kush është dakord?**

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

*Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)*

*Kundër: s'ka!*

*Jemi dakord të 5, miratohet!*

*Znj. H. Vukaj:* Pika 3 mendoj që të qëndrojë e pandryshuar, pra “Kontratë qiraje ose huapërdorje të banesës” dhe po vijoj me pikën 4.i “Dokument/e bankare (kontratë kredie, vërtetim/statement bankar etj.) e cila përmban adresën e banimit”. Ky ishte propozimi.

*Z. M. Çakaj:* Vetëm “vërtetim”.

*Znj. I. Nano:* “Statement” i bie të na dërgojë ...

*Znj. H. Vukaj:* Në rregull.

*Znj. I. Nano:* Pra vërtetim.

*Znj. H. Vukaj:* Në gjuhën shqipe patjetër që i shkon.

*Znj. I. Nano:* Dokumente bankare, që përmban...

*Znj. H. Vukaj:* Që përmban adresën e banimit.

*Znj. I. Nano:* Jeni dakord për këtë pikë? Kjo do të zëvendësojë, pra ju propozoni atë që e kemi “Kontratë kredie”

*Znj. H. Vukaj:* “Kontratë kredie për blerjen e banesës”.

*Znj. I. Nano:* Është zgjeruar, le të themi.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Duke qenë që nuk mund të jetë vetëm një dokument i cili mund të vërtetohet banesën përmes lidhjes me bankën, ka të tjerë dokumenta bankarë që e provojnë, apo arsye përse merret kredi është variabël. Kështu që më mirë të zgjerohet.

**Znj. I. Nano:** Në rregull. Kalojmë në votimin e kësaj pike?

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s'ka!**

**Miratohet me 5 vota pro!**

Kemi diçka tjetër znj. Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Po, do ndalesha edhe në pikën 9.i, në mos gaboj “Dokument të lëshuar nga”, jo, ndjesë. Atëherë përpara pikës 9.i eksistuese unë do të shtoja një pikë tjetër, e cila erdhi edhe nga konsultimi me organizatat e diasporës, “Leje drejtimi (patentë) në rastet kur shënohet adresa e banimit”.

**Znj. I. Nano:** Pra, leje drejtimi të automjetit.

**Znj. H. Vukaj:** Po, leje drejtimi automjeti.

**Znj. I. Nano:** Në fakt nga konsultimet me organizatat e diasporës, padyshim në disa vende, në disa shtete leja e drejtimit përmban adresën, në disa jo, kështu që edhe unë e gjej me shumë vend pjesën kur shënohet adresa e banimit. Atëherë kalojmë në votimin e kësaj pike.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s'ka!***

***Me 5 vota pro miratohet!***

Miratohet dhe ky ndryshim. Kam dhe unë një propozim për pikën 1, të kreut 2, sikundër kolegët e thanë më herët, sikundër ne e verifikuam gjatë diskutimeve qoftë në mbledhjen e kaluar, qoftë në takime me shoqatat e diasporës, padyshim lista është e detajuar, po nuk është shteruese se nuk mund të jetë shteruese. Unë propozoj që të shtojmë një pikë të fundit: “Ose çdo dokument tjetër i lëshuar në shtetin e huaj që provon qëndrimin e shtetasit shqiptar në adresën e vetëdeklaruar jashtë vendit.” Pra, mbasi janë miratuar disa nga këto dokumenta që kërkohen, i hapim rrugën edhe dokumentave të tjerë që mund të përdoren. E rëndësishme është që të vërtetojnë adresën, të përputhen me adresën e vetëdeklaruar jashtë vendit. Zonja Vukaj.


***Znj. H. Vukaj:*** Më lejoni znj. Nano, në shtrirje të gamës të sqaroj nëse ju e keni parasysh faktin, “i lëshuar në shtetin e huaj” edhe të institucioneve jopublike?

***Znj. I. Nano:*** Në fakt po.

***Znj. H. Vukaj:*** Mjafton të jetë lëshuar në shtetin e huaj?

***Znj. I. Nano:*** Pra nëse do thoshim “nga shteti i huaj”, atëherë do të kishim të bënim vetëm me dokumenta të lëshuar nga autoritetet shtetërore, por propozimi është “në shtetin e huaj”.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

*Znj. H. Vukaj:* Dakord.

*Znj. I. Nano:* Kalojmë në votimin e kësaj pike?

*Kush është dakord kolegë?*

*Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)*

*Kundër: s'ka!*

*Miratohet me 5 vota pro!*

Atëherë kemi, do më duhet të kaloj në... Po, zoti Çakaj!

*Z. M. Çakaj:* Atëherë një sqarim se besoj se s'ka nevojë për pyetje. Një sqarim edhe për administratën. Me miratimin e kësaj pike të fundit të propozuar nga Kryetarja znj.Nano, pra “Ose çdo dokument tjetër i lëshuar në shtetin e huaj që provon qëndrimin e shtetasit shqiptar në adresën e vetëdeklaruar jashtë vendit”, si dhe me miratimin e të gjithë listës joshteruese të dokumentacionit të cilin ne sapo e miratuam. Është shumë e rëndësishme të theksojmë dhe besoj se do gjejë zbatim edhe në implementimin e këtij procesi të regjistrimit, fakti që shtetasit shqiptar që banojnë jashtë vendit janë në vende të ndryshme, duke filluar që nga vende fqinje, Greqi, Itali, Zvicër, Gjermani deri në vendet në kontinentet më të largëta, Amerikë e Veriut, Amerikë e Jugut, Australi, Afrikë, Azi. Kështu që unë besoj se është e qartë që dokumenti, të cilin do të ngarkojnë në sistem për regjistrim, shtetasi shqiptar me banim do të pranohet siç është lëshuar. Pra, në gjuhën që është lëshuar, anglisht, frëngjisht, spanjisht, siç e ka lëshuar shteti i huaj apo autoritetet e ndryshme shtetërore apo private në shtetin e huaj. Pra nuk do të kemi pengesa në regjistrimin.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Ju lutem një pyetje. Po, pa diskutim do jetë kështu në zbatim, për shkak të votimit pikë për pikë. Doja vetëm një sqarim ju lutem, vetëm në zbatim të pikës që znj. Vukaj propozoi pas pikës së parë, në mos gaboj “Vërtetimi për rezidencën”

**Z. M. Çakaj:** Dokument.

**Znj. H. Vukaj:** “Dokument që provon rezidencën në shtetin e huaj, i lëshuar nga autoriteti përkatës”. Për të sjellë shembullin e Italisë, e cila një nga format e dokumentit është ID, ku pasqyrohet adresa.

**Znj. J. Josifi:** Kjo ju lutem është pyetja ime, në zbatim, në kuptimin a mos do të duhet në këtë pikë, në vijim të të gjithë fjalisë të propozuar nga ju të themi “ku përcaktohet adresa”? Se nuk është thënë në këtë pikë, ndryshe nga pikat e tjera, se mundet që Italia, për shembull e ka adresën në rezidencë, kurse një vend tjetër...

**Znj. H. Vukaj:** Po kështu kufizohet sepse kemi parasysh ku është përcaktuar adresa, ndoshta këtë shembullin që sapo solla, mund të jetë një vërtetim.

**Znj. J. Josifi:** Do duhet ta ketë adresën?

**Znj. H. Vukaj:** Po patjetër që e ka rezidenti x, me këtë vendbanim, e specifikon.

**Z. M. Çakaj:** Thjesht formulimi.

**Znj. J. Josifi:** Dakord. Kemi vetëm merakun nëse ka ndonjë vend që në lejen e rezidencës nuk e ka adresën, të plotë të shënuar.

**Znj. H. Vukaj:** Nëse ke leje rezidence, automatikisht e ke të përfshirë adresën.

**Znj. J. Josifi:** Dakord, jemi të qartë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Zonja Josifi, formulimi i propozuar dhe i miratuar nga ne besoj është i qartë “Dokument që provon rezidencën”. Pra, koncepti juridik “provon rezidencën” do të thotë që dokumenti i cili paraqitet ka të dhëna të mjaftueshme që identifikon rezidencën në shtetin e huaj, pra provon rezidencën. Besoj është e qartë kjo.

**Znj. J. Josifi:** Faleminderit!

**Znj. H. Vukaj:** Pra dhe njëherë, gama e gjerë, jo shteruese dhe ajo që sapo zonja Nano propozoi, pra arrin qëllimin e gjithëpërfshirjes, por dhe të lehtësisë në të njëjtën kohë. Në momentin kur themi “Dokument të lëshuar në shtetin”, mjafton që ku lloj dokumenti të ketë atë personalitetin juridik, pra t’i përkasë një autoriteti që e lëshon, më pas mban përgjegjësi autoriteti në qoftë se lajthit apo kalon në gafë të nënvleftësimit të vërtetësisë.

**Znj. I. Nano:** Vetëm për pikën 1, duke qenë që ne bëmë disa ndryshime, na kanë ngelur pa votuar ato që kemi pasur në projektakt, ta votojmë në tërësi pikën 1?

**Z. M. Çakaj:** Po kam dhe unë dy propozime.

**Znj. I. Nano:** Kreu 2, pika 1.

**Z. M. Çakaj:** Dakord e votojmë.

**Znj. I. Nano:** Atëherë votojmë në tërësi pikën 1, të kreut 2 kolegë? Pra me ndryshimet që pësoi këtu në seancë?

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

***Kundër: s'ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Zoti Çakaj propozim tjetër?

**Z. M. Çakaj:** Atëherë në kreun 2 unë kam një propozim, që të shtohet pika 2. Ku të parashikohet kufizimi i numrit të shtetasve të cilët kanë të drejtë të aplikojnë vetëm në një adresë. Nisur nga tipologjia e familjes shqiptare që është një familje kryesisht e mesme, por për të qenë dhe më racional për të përfshirë numrin më të madh të një familje shqiptare, me të drejtë vote jashtë vendit. Por nga ana tjetër për të shmangur gjithë manipulimet në rast se dikush do të synojë qoftë nga forcat politike apo jo politike. Unë propozoj që këtu të vëmë një kufizim, më konkretisht formulimi që unë propozoj është të shtohet pika 2 me këtë përmbajtje: “Numri i shtetasve shqiptarë të regjistruar në të njëjtën adresë që aplikojnë në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) për regjistrim në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit nuk mund të jetë më shumë se 6”. Sigurisht do duhet të shtojmë dhe rezervën ligjore në rastin konkret ose përjashtimin nga ky rregull. Konkretisht, vetëm për shkaqe të përligjura dhe pas paraqitjes së dokumentacionit provues ligjor, PER do të lejojë regjistrimin në të njëjtën adresë më shumë se të 6 shtetasve shqiptarë. Këtu besoj kemi parasysh rastet kur ka shumë shtetas shqiptar të regjistruar në të njëjtën adresë, siç janë kampuset, siç janë kampe emigracioni, institucione shëndetsore, azile apo tjerë. Pra, formulimi integral i pikës 2 të jetë konkretisht “Numri i shtetasve shqiptarë të regjistruar në të njëjtën adresë që aplikon në PER për regjistrim në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit nuk mund të jetë më shumë se 6, vetëm për shkaqe të përligjura dhe pas paraqitjes së dokumentacionit provues ligjor PER do të lejojë regjistrimin në të njëjtën adresë të më shumë se 6 shtetasve shqiptarë.”

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit koleg! Atëherë votojmë propozimin e z. Çakaj, për të shtuar një pikë 2, në kreun 2, me përmbajtjen që sapo u lexua.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s'ka!**

**Me 5 vota pro miratohet!**


Pra, në kreun 2 u votua titulli i ndryshuar, u votua pika 1, e ndryshuar dhe u shtua një pikë 2. Kalojmë në kreun 3 “Dispozita të fundit”

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Më falni!

**Znj. I. Nano:** Po, më falni. Ju pashë shumë qetë sot dhe s’po prisja që të merrnit fjalën.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Meqenëse po kaloni te kreu 3, përpara kësaj kisha një propozim nga ana e Partisë Demokratike, që pata rastin ta shpreh edhe gjatë takimit që patëm në Zoom, online. Të shtohet, është propozimi ynë, një pikë 3, te kreu 2, në lidhje me procesin. Pra, për ta bërë dhe më konkrete, në lidhje me monitorimin po themi të këtij dokumentacioni por edhe të numrit të aplikimeve, që sapo u miratua pika 2. Pra, numri i personave që banojnë në atë adresë. Propozimi ynë konkret është që pika 3 të ketë këtë përmbajtje “Ky proces do të mbikqyret dhe monitorohet nga auditët teknikienë, të propozuar nga partitë politike, të akredituara në KQZ, e të mbikqyrura nga Nënkomisioneri Shtetëror për Zgjedhjet dhe Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet”, pra bashkërisht. Raportimi i audituesve teknikienë që monitorojnë dhe mbikqyrin vlerësimin e

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

dokumentacionit që provon qenien e zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të jetë ditor.


**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Pra, ideja është që këta auditues teknikienë të raportojnë njëkohësisht dhe te Komisioneri dhe te Nënkomisioneri. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Propozim tjetër? Zonja Xhina propozim apo?

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS:** Faleminderit! Atëherë lidhur me propozimin që vjen sërish nga z. Nuri duhet t'ju rikujtoj që në vendimin e kaluar që ju miratuat, projektvendimi, prej tij buron akti që ne jemi duke shqyrtuar. Keni miratuar pikën 6 në mos gaboj dhe aty mund të kuptojmë fare qartë që auditit teknikien, detyrim që buron nga Kodi Zgjedhor, e fillojnë mbikqyrjen, kontrollin, mund ta themi si ta duam ne dhe monitorimin që nga momenti i regjistrimit të zgjedhësit në platformë. Pra, nuk ka asnjë kufizim sepse vetë dispozita thotë që auditët teknikienë të miratuar sipas ligjit duke përmendur Kodin Zgjedhor kryejnë verifikime të veprimeve dhe detyrave të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit pakufizim në drejtim të ngritjes së pyetjeve dhe kërkesave për verifikim. Jo pa qëllim nga ana juaj është vendosur terminologjia “pakufizim” në drejtim të ngritjes së pyetjeve dhe kërkesave. Ata mund të kryejnë të gjitha veprimet, që nënkupton monitorimin, kontrollin, mbikqyrjen etj. Akti që ne jemi duke shqyrtuar sot bën fjalë pikërisht për regjistrimin e zgjedhësve. Pra, jemi tek kjo fazë procedurale që jemi duke shqyrtuar dhe në fakt nga ana juaj është parashikuar mekanizmi se si auditët teknikienë e kryejnë kontrollin. Kështu që mendoj që është e ezauruar si pikë dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

mbulohet më së miri nga akti i miratuar nga ana juaj disa ditë më parë dhe që është akt nga i cili buron dhe akti i sotëm. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Xhina! Zoti Nuri.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Faleminderit për mundësinë! Një sqarim të vogël dhe për parafolësen. Ne gjykojmë se ky propozim gjen bazë jo vetëm në aktet e miratuara më herët por dhe në precedentët e mëparshëm, neni 61 i Kodit, ka pak a shumë të njëjtën mekanizëm që funksionon për auditët e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, është e njëjta logjikë. Ka dhe precedentë të tjerë ku raportimet ekzistojnë dhe ne mendojmë që duke shtuar dhe duke specifikuar këtë gjë jemi më të qartë në lidhje me respektimin e kriterëve dhe kërkesave ligjore. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Nuri! Në fakt ne sapo miratuam në këtë vendim heqjen e një fjalie që ishte përsëritje nga vendimi i kaluar. Personalisht e konsideroj që monitorimi nga auditët teknikienë sipas Kodit Zgjedhor e kemi në aktin e kaluar. Gjithsesi nëse kolegët kanë diskutim përpara se të kalojmë në votim. Zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Që të mos biem në përsëritje dhe nuk mendoj se është përsëritje sepse z. Nuri ka parasysh posaçërisht këtë proces, pra këtë fazë posaçërisht dhe jo gjithë fazat. Se parimin e miratuam, ata ndërhyjnë dhe mbikqyrin, monitorojnë, duhet të raportojnë çdo fazë, me kërkesë të partive. Pra, ideja është që ashtu sikundër kemi vepruar në rastet e tjera për identifikimin, implementimin e identifikimit elektronik, ku institucionalisht organi përgjegjës apo final i mbikqyrjes së procesit ka qenë Nënkomisionerja, ashtu si dhe Komisioneri. Unë e gjej me vend këtë propozim, pasi i rrit garancinë dhe është një mjet kontrolli,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

sigurie për të gjithë implementimin dhe zbatimin e procesit, sepse në këtë tryezë ne dëgjuam pak më parë gjatë propozimet tona dhe shtesave që u bëmë në këtë akt, që lindën dilema të vogla. Po me implementimin si do të jetë? Kështu që në këtë kuadër unë mendoj që ky propozim, jo vetëm sjell garancitë për këtë fazë të procesit. Shumë e rëndësishme kjo fazë e procesit, e para bëhet për herë të parë, e dyta kemi një platformë elektronike dhe e treta ne kemi ushtruar në këto 4 vjet këtë garanci përmes bashkërendimit të të dy organeve publike këtu, ekzekutiv siç është Nënkomisioneri dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Personalisht e mbështes dhe më duket shumë adekuate për t'i dhënë një mjet garancie. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit znj. Vukaj! Kalojmë në votimin e propozimit të z.Nuri për një shtesë, në kreun 2, pra për të shtuar pikën 3 sipas propozimit që ai lexoi.

***Kush është dakord?***


***Pro: 2 (z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: 3 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela)***

***Me 2 vota pro dhe 3 kundër nuk miratohet!***

Nuk miratohet propozimi i z. Nuri. Kalojmë në kreun 3, “Dispozita të fundit”. Pika 1 “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim me zbatimin e tij. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.” Kolegë ka vetëm diçka të vogël, duke qenë se më

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

herët ne hoqëm një fjali që përfshinte dhe institucion tjetër siç ishte DPGJC-ja, ndoshta për teknikë “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me zbatimin e tij”

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, së pari siç e kemi ritheksuar dhe në mbledhjet e tjera, institucioni i ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi, së pari është Komisioneri dhe më pas administrata e KQZ-së. Pra, ky akt ngarkon me detyra specifike edhe Komisionerin për hartimin e gjithë infrastrukturës me qëllim implementimin e gjithë procesit, përgatitës së infrastrukturës PER, në mënyrë që ky proces të administrohet sa më mirë. Kështu që unë vlerësoj që çdo akt i cili ka të bëjë me votimin nga jashtë specifikisht, meqë dhe ligjvënësi e ka ngarkuar Komisionerin, së pari me detyra për të propozuar këto akte dhe së dyti institucioni kryesor përgjegjës për këtë proces është Komisioneri Shtetëror dhe sigurisht dhe administrata e KQZ-së. Kështu që unë besoj, që në pikën 1 të shtohet dhe fjala “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve” dhe sigurisht administrata e KQZ-së. Jam dakord me propozimin e znj. Nano që të hiqet DPGJC-ja meqë e modifikuam këtë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Në fakt kolegë për diskutimin para se të shkojmë në votim. Padyshim që qoftë Rregullatori, qoftë Komisioneri, qoftë KAS-i detyrat i marrin drejtpërdrejt nga ligji. Në qoftë se në aktin e kaluar ne ngarkuam KQZ-në dhe nënkuptuam Komisionerin për miratimin e një akti, unë nuk kuptoj se çfarë detyrash i rrjedhin Komisionerit nga ky vendim që ka një listë dokumentacioni që duhet ta plotësojë zgjedhësi. Prandaj, thjesht për ta parë si ide.

**Z. M. Çakaj:** Për ta qartësuar, konkretisht nga gjithë propozimi dhe miratimi i këtij akti i lindin dy detyra kryesore. Së pari të përshtasë PER për pranimin e gjithë dokumentacionit, listën e dokumentacionit, në gjuhën nga ku lëshohet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

dokumentacioni. Së dyti të përgatisë dhe të përshtasë PER për një modalitet që të kufizohet numri i shtetasve dhe vetëm në rastin kur dokumentacioni, pra përligjet me dokumentacion provues, atëherë do të mund të lejohet regjistrimi i më shumë se 6 shtetasve në një adresë. Kështu që unë besoj se e ngarkon me këto detyra.

**Znj. I. Nano:** Po pra kush është detyra konkrete?

**Z. M. Çakaj:** Që ta përshtasë PER-in sepse në rastin...

**Znj. I. Nano:** Këta s'e kanë ngritur PER-in akoma, pastaj të përshtatet.

**Z. M. Çakaj:** Një sekond, në nenin 25 të Kodit Zgjedhor përcaktohet në mënyrë specifike se KQZ krijon dhe mirëmban Platformën Elektronike të Regjistrimit të zgjedhësve.

**Znj. I. Nano:** E kemi theksuar në aktin e kaluar që KQZ-ja miraton me akt më vete.

**Z. M. Çakaj:** Shumë dakord, po krijimi i platformës, sigurisht përcaktimi i gjithë rregullave dhe mënyra e organizimit janë dy...

**Znj. I. Nano:** S'kemi rregulla, i miratuam me aktin e parë.

**Z. M. Çakaj:** Implementimin e platformës dhe administrimin e platformës do ta bëjë në mënyrë specifike Komisioneri dhe sigurisht lista e këtyre dokumentave do të ngarkohet në këtë platformë. Unë nuk e kuptoj se pse duhet të vijojmë diskutimet.

**Znj. I. Nano:** E keni te akti, ndaj mos të biem në përsëritje. Znj. Josifi e ke aktin nr. 10?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Këto akte janë të asaj natyre të cilat në mënyrë specifike ngarkohet Komisioneri dhe administrata dhe kur është vendi dhe institucione të tjera ngarkohen nga ligji. E kemi pa kufizim këtë dispozitë nga Kodi Zgjedhor.

**Znj. H. Vukaj:** Do më lejoni të shtoj diçka kolegë? Ju, më lart, znj. Nano përmendët faktin që Komisioneri apo të gjithë ne, trupa drejtuese, marrin detyrat nga ligji, por në qoftë se ne i marrim thjesht dhe kaq ftohtë detyrat nga ligji nuk do të kishte nevojë që ne të miratonim akte, të cilat jo vetëm që normojnë mirë por i zbërthejnë mirë aplikimin që duhet të bëjë Komisioneri. Kështu që organi ekzekutiv i cili bën aplikimin në çdo fazë të të qenit të procesit, padiskutim që është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, më pas administrata e cila është e ngarkuar për të bërë punën e nivelit poshtë përgjegjësisë së Komisionerit. Pra, në qoftë se administrata në të gjithë këtë fazë do të ketë nevojë për përkthyes supozoj, për operator, për çfarëdo lloj nevojë që mund të dalë gjatë rrugës, për një manual që të kuptohemi më mirë, padiskutim që do jetë...

**Z. M. Çakaj:** Edhe për shtimin e numrit të kontaktimit i personave nga jashtë, te Drejtoria e Votimit nga Jashtë me qëllim administrimin në kohë të të gjithë kërkesave dhe shqyrtimin e listës së dokumentacionit. Supozojmë një situatë, se këtë nuk e ka tagër ta bëjë administrata, supozojmë se do të kemi në një muaj, në një periudhë shumë të shkurtër mund të kemi 100 apo 150 mijë kërkesa, atëherë nga do ta marrë autorizimin? Administrata do ta bëjë?

**Znj. H. Vukaj:** S'e bën dot administrata...

**Z. M. Çakaj:** Në rast se ne i ngarkojmë detyra...

**Znj. H. Vukaj:** ...as i drejtohet Këshillit të Ministrave për shtesë në buxhet, as për nevoja të tjera, as institucioneve të tjera, padiskutim që e bën Komisioneri, i cili

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

në çdo akt që do të vijë për këtë proces duhet të jetë pjesë. Kështu që administrata ta ketë parasysh kur të ...

**Z. M. Çakaj:** Më fal, sjell në vëmendje dhe në nenin që doni bazën specifike ligjore, ku unë mendoj se është e qartë tashmë.

**Znj. I. Nano:** Të qartësohemi dhe ne.

**Z. M. Çakaj:** Neni 25, pika 4, të Kodit Zgjedhor, parashikohet në mënyrë shteruese se hapja e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë njoftohet publikisht nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet. Këtë e kemi miratuar, këtë nen në vendimin nr.10. Atëherë procesi i regjistrimit ka dy momente kryesore, së pari ka momentin e identifikimit, së dyti momentin e ngarkimit të një dokumenti. Pra kjo është në kuadër të procesit të regjistrimit. Unë e gjej me vend ta ngarkojmë Komisionerin, pikërisht në të gjitha aktet me çfarë kanë të bëjnë me regjistrimin. Siç ju e theksuat dhe në vijim në datën 23 shtator kjo listë ka qenë pjesë e aktit bazë, pra aktit të regjistrimit, ku ne kemi ngarkuar me detyra specifike Komisionerin.

**Znj. I. Nano:** Në projektvendim nuk ka qenë.

**Z. M. Çakaj:** Në projektvendimin e parë, jo në projektvendimin e sjellë.

**Znj. I. Nano:** Në projektvendim nuk ka qenë. Në vendimin që kemi miratuar ne jo në projektvendim e qarkulluar dhe konsultuar me 23 shtator.

**Z. M. Çakaj:** Në projektvendimin e sjellë për njohje ka qenë dhe lista.

**Znj. I. Nano:** Lista po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Z. M. Çakaj:** Ne këtë po miratojmë, listën dhe më pas u konsultua, u diskutua që të miratohej në një akt të veçantë, pra të kishim një proces konsultues më të gjerë. Kështu që unë nuk i shikoj të ndara këto procese dhe sigurisht ngarkimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me një detyrim që buron nga ligji, nga Kodi Zgjedhor dhe sigurisht buron dhe nga akti jonë pararendës që nuk e shikoj problem.

**Znj. I. Nano:** Dakord, u bë propozimi, ta kalojmë me votë.

**Z. M. Çakaj:** Dakord.

**Znj. H. Vukaj:** Nuk shikoj ndonjë problem se pse të mos jetë Komisioneri kur janë akte që do t'i zbatojë ai, e para. E dyta në qoftë se Komisioneri nuk është...

**Znj. I. Nano:** Do t'i zbatojë administrata.

**Znj. H. Vukaj:** Administrata i zbaton pas atij, ai është Gjenerali i administratës.

**Znj. I. Nano:** Ne s'jemi Kryegjeneralë që ngarkojmë me detyra Gjeneralët e tjerë.

**Znj. H. Vukaj:** Ne kemi këtë detyrën para ligjit, ai Gjenerali nuk bën dot pa këto akte se përndryshe nga ligji ai s'merr dot spunto, po s'bëmë ne këto aktet. Kështu që unë mendoj që duhet të jetë Komisioneri sepse në qoftë se nuk do të jetë atëherë këtu, kjo nuk është një fjali e thatë që po kalojmë radhën, pra anën formale të aktit. Kjo duhet të jetë një fjali e cila vërtet ngarkon me përgjegjësi dhe unë në qoftë se s'është Komisioneri dua të di këtu, kush konkretisht nga administrata e KQZ-së? Ma thoni këtë dhe pastaj po heqim Komisionerin.

**Znj. I. Nano:** Nuk është çështje përgjegjësie...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Absolutisht!

**Znj. I. Nano:** ...është ngarkim me zbatimin e këtij vendimi. Zbatimi i këtij vendimi ka një përmbajtje të caktuar.

**Znj. H. Vukaj:** Ngarkohet se lidhet me përgjegjësinë.

**Znj. I. Nano:** Me zbatimin e atij vendimi që miratojmë.

**Znj. H. Vukaj:** Sepse mund ta dështojë ky grupi, mund të tentojnë ta dështojnë.

**Znj. I. Nano:** Mund të tentojnë ta dështojnë është shumë e rëndë, kjo që thoni në mbledhje publike znj. H. Vukaj. Mund të tentojnë, kush do të tentojë ta dështojë?


**Znj. H. Vukaj:** Kjo është në logjikë zonjë. Mos merr rëndesa se s'po çenojmë askënd në mënyrë nominative, po është logjika.

**Znj. I. Nano:** E the dhe në numrin shumë, qenkan shumë që tentojnë ta dështojnë!

**Znj. H. Vukaj:** Merru me parimin mos u merr me lulet e fjalëve sepse nuk kanë kuptim. Nuk e kuptoj pse përbën shqetësim që futëm Komisioneri. Është vlerë për aktin.

**Znj. I. Nano:** Unë mendimin tim e paraqita dhe më herët lidhur me ngarkimin nga ligji me detyra dhe jo me detyra ekstra. Ne nuk mundet të ngarkojmë në rastet kur s'ka detyra konkrete. Ky është mendimi im personal. Kemi diskutime, kemi pasur gjatë këtij akti. Ky është që sapo lindi, gjithë të tjerat i kemi diskutur në mbledhje online, mbledhje afër, mbledhje nga larg, e të tjera me radhë. Kështu që kemi për të votuar kreun... Me kërkesë të kolegut 5 minuta ndërpreje mbledhje dhe rifillojmë pas pak.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024  
Rifillon seanca*

*Ora 15:10*

**Znj. I. Nano:** Rifillojmë mbledhjen që e ndërpreme pak më herët. Morëm pak më shumë kohë sesa thamë në fillim për të bërë një diskutim me kolegët dhe le të mendojmë se një nga kolegët e kemi larg, është online dhe ishim në vështirësi për t'u lidhur me të. Dëgjohemi tani te ju?

**Z. D. Çaka:** Po unë ju dëgjoj dhe ju shoh, nuk e di ju si më dëgjoni dhe shihni?

**Znj. I. Nano:** Dakord, të dëgjojmë shumë mirë. Atëherë morëm pak më tepër kohë për të diskutuar çështjen ku mbetëm pasi dhe lidhja me kolegun ishte pak e vështirë. Kështu që jemi tek kreu 3, te “Dispozita të fundit”. Kolegu Çakaj do të bëjë një propozim të ri për ta riformuluar pikën 1, të kreut 3, “Dispozita të fundit”. Zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit e nderuar! Atëherë pasi u konsultuam dhe me njëri-tjetrin, pasi ridiskutuam nën frymën edhe të nenit 24, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet në mënyrë eksplicite se votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjithë aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë sipas këtij Kodi dhe çdo organ shtetëror shqiptar dhe çdo ent tjetër shtetëror ose privat që përfshihet në këtë proces, janë të detyruar të zbatojnë rregullat e përcaktuara në këtë Kod dhe në akte nënligjore që miraton KQZ-ja në zbatim të tij. Në këtë frymë konstatohet se ligjvënësi ka autorizuar Komisionin Rregullator, me qëllim implementimin e procesi kaq të rëndësishëm, rregullat dhe aktet nënligjore që do të miratojë Komisioni Rregullator janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo organ shtetëror, jo vetëm shtetëror por edhe privat. Pra nuk ka

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

kufizime në identifikimin e organeve që ngarkohen. Nën këtë frymë unë propozoj që pika 1 të riformulohet si më poshtë “Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile si dhe çdo organ shtetëror shqiptar sipas parashikimeve të nenit 24, pika 3, të Kodit Zgjedhor, me detyra për zbatimin e këtij vendimi.” Pjesa tjetër të vijojë siç është.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Çakaj! Atëherë për pikën 2 dhe 3 nuk besoj se kemi gjë. Për pikën 1 kemi propozimin, kështu që votojmë kreun 3, me propozimin e z.Çakaj.

**Kush është dakord kolegë?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s’ka!**

**Me 5 vota pro miratohet!**

Kemi votuar në parim këtë projektvendim, kemi kaluar kre për kre, nen për nen, pikë për pikë. Gjatë diskutimit ka pësuar disa ndryshime është momenti për ta votuar në tërësi, ku përfshihen të gjitha ndryshimet. Edhe njëherë kolegë votimi i fundit për sot. Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s’ka!**

**Miratohet me 5 vota pro!**

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 01.11.2024*

Miratuam vendimin “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit.” Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës apo jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Ka z. Çaka? Po. Koleg nuk dëgjoheni.

**Z. D. Çaka:** Faleminderit zonja Kryetare, më dëgjoni besoj tani?

**Znj. I. Nano:** Po tani dëgjoheni.

**Z. D. Çaka:** Duke qenë se jemi shumë afër dhe afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor për përmbushjen e detyrimeve tona si Komision Qendror i Zgjedhjeve, në veçanti ne si Rregullator. Unë do të kisha një përsëritje të kërkesës për administratën, në mënyrë që të na sillte sa më shpejt dhe aktet e tjera për të procesuar në mënyrë që jo vetëm të kapim afatet po dhe të mundësojmë këtë proces të rëndësishëm historik, në të cilin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe mbi të gjitha shqiptarët që jetojnë dhe punojnë apo studiojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ka në këto momente. Kështu që, zonja Josifi besoj ju lutem sa më shpejt pjesën e akteve, besoj do të kenë ngelur dhe dy javë që t’i miratojmë, pra t’i shohim dhe t’i miratojmë dhe ne si Komision Rregullator, sa më shpejt. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Besoj që bashkohemi të gjithë me shqetësimin e paraqitur nga z.Çaka. Meqenëse se s’kemi çështje të tjera për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

**Vendim nr.11**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

